

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE (2023)

| Nr. Rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës   | Data e përgjigjes | Përgjigje   | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa    |
|------------|-----------------|--|-------------------|---|----------------------------------|-----------|
| 1          | 17.01.2023      | <p>1.Në çfarë faze janë punimet për ndërtimin e maternitetit të ri të Kukësit?</p> <p>2.Kur pritet të jetë gati për të ofruar shërbim?</p> <p>3.Sa është vlera e investimit për këtë maternitet?</p> <p>4.Sa pacientëve u shërben materniteti i ri?</p>  | 18.01.2023        | Kthyer përgjigje me e-mail  | E plotë                          | Pa pagesë |
| 2          | 23.01.2023      | <p>1. A keni ofruar mbështetje financiare per organizatat jofitimprurese (OJF) gjate vitit 2022?</p> <p>2. Nese keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qene forma e mbështetjes (grant, kontrata sherbirmi, prokurim publik/tenderim, etj.)</p> <p>3. Sa OJF kane aplikuar per rmbështetje financiare gjate vitit 2022? Ju lutem, specifikoni sipas formes se mbështetjes, nese ka patur me shurne se nje forme.</p> <p>4. Sa OIF kane perfituar nga kjo mbështetje? Ju lures, specifikoni</p> | 31.01.2023        | <p>1. Bashkia Kukës ka ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse gjate vitit 2022.</p> <p>2. Forma e mbështetjes ka qenë në formë Grant (bashkëfinancim) dhe partneriteteve.</p> <p>3. Gjatë vitit 2022 kanë aplikuar gjithsej 27 Organizata të Shoqërisë Civile të cilat kanë aplikuar në dy thirrje publike shpallur nga Bashkia.</p> <p>4. Kanë përfituar gjithsej 5 OJF.</p> <p>5. Disbursimi ka qenë në masën 21.3 % për secilin fitues granti. Totali i</p> | E plotë                          | Pa pagesë |

|  |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|
|  |  | <p>sipas formes se mbeshtetjes nese ka patur me shurne sc nje forme</p> <p>5. Cila ka qene buxheti i disbursuar per organizate dhe ne total? Ju lutem, specifikoni sipas formes nese ka patur me shume se nje forme</p> <p>6. Keni ofruar rmbeshtetje jofinanciare gjate vitit 2022? Ci la eshte baza ligjore rregullatore qe rregullon kete forme rmbeshtetjeje?</p> <p>7. Nese keni ofruar mbeshtetje financiare, sa OIF kane perfituar nga kjo mbeshtetje? Cili ka qene Iloji I mbeshtetjes jofinanciare te ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)?</p> <p>8. Sa eshte numri i konsultirneve publike te realizuara nga institucioni juaj gjate vitit 2022?</p> <p>9. A ka institucioni juaj koordinator per njoftimin dhe konsultirnin publik? Nese po, ju lutem citoni kontaktin.</p> <p>10. A ka institucioni juaj koordinator per shoqerine civile? Nese po,ju lutem citoni kontaktin.</p> <p>11. Sa OJF kane rmarre pjese ne konsultime publike te organizuara nga Institucioni juaj?</p> <p>12. Sa perqind (%) e projektligjeve I akteve nenligjore te hartuara nga institucioni juaj jane si rezultat I konsultimeve me OJF-te?</p> <p>13. Ajane te perfshire perfaqesues te</p> |  | <p>grantit te disbursuar është 737,393 Leke.</p> <p>6. Mbështetja jo-financiare për OJF-ët ka qenë nëpërmjet ofrimit të sallave të bashkisë Kukës dhe bashkëpunimit me stafet teknike brenda bashkisë sipas marveshjeve të nënshkruara në mes palëve.</p> <p>7. 5 OJF kanë përfituar nga mbështetja financiare. Mbështetja jofinanciare ka qenë në formën e: ofrimit të sallave, mbështetja nga stafet teknike në hartim projektsh narrative dhe teknike, mbështetje me makineri dhe me punëtorët e shërbim _gjelbërimit në zbatimin e projekteve mjedisore, etj.</p> <p>8. Numri i konsultimeve publike për vitin 2022 janë 5 gjithsej. (PBA, Pakta Fiskale, PPV)</p> <p>9. Bashkia nuk ka në strukturën e saj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky funksion realizohet nga nëpunësit e Këshillit Bashkiak dhe të drejtorive respektive në varësi të tematikes.</p> <p>10. Nuk ka koordinator për shoqërinë civile.</p> <p>11. Gjatë konsultimeve publike kanë marrë gjithsej 3 përfaqësues të OJF.</p> <p>12. Nuk ka asnjë akt ligjore dhe nënligjore e miratuar sic përshkruhet</p> |  |  |
|--|--|--|--|--|--|--|

|   |            |  |            |   |         |           |
|---|------------|--|------------|---|---------|-----------|
|   |            | <p>OJF-ve ne organe keshillimore te institucionit tuaj? Nese PO, cilat jane keto organe keshillimore dhe sa OJF jane te perfshire ne to?</p> <p>14. A jane perfshire OJF ne grupet e punes se ngritura te institucionit tuaj? Nese PO, cilat jane keto grupe pune dhe sa OJF jane te perfshire ne to?</p> <p>15. A eshte trajnuar stafi juaj mbi veprimtarine dhe funksionimin e OJF-ve? Nese po, sa punonjes jane trajnuar?</p> <p>16. A ka lincensuar institucioni Juaj OJF qe ofrojne sherbirne te caktuara? Nese po, sa OJF jane lincensuar? Per cfare sherbimesh jane lincensuar?</p> |            | <p>ne ketë pike.</p> <p>13. Përfaqësuesit e OJF nuk janë të përfshirë në organet këshillimore të institucionit por janë shpesh herë pjesë e konsultimeve publike dhe mbledhje e Këshillit Bashkiak</p> <p>14. OJF-ët nukjanë të përfshirë në grupet e punës së Bashkisë.</p> <p>15. Nuk ka trajnime</p> <p>16. Bashkia Kukës nuk ka licencuar OJF që ofrojnë shërbime të caktuar.</p>   |         |           |
| 3 | 01.02.2023 | <p>Bashkia ne proceset e integrimit evropian</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Te dhena mbi projektet, nismat dhe veprimtarite e bashkise ne kuadrin e integrimit ne BE</li> </ol> <p>Bashkia dhe shoqeria civile</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Ne teresi te dhena per grupet e interest</li> <li>3. Te dhena per OJF-te, perfaqesuesit e medias, biznesit</li> <li>4. Sherbime qe ofrohen nga organiozata te ndryshme</li> <li>5. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqeria civile</li> </ol>  | 08.02.2023 | <p>Të dhënat mbi projektet, nismat dhe veprimtaritë e bashkisë në kuadër të integrimit në BE, i gjen në linkun:</p> <p><a href="https://kukesi.gov.al/projektet-ne-zbatim/">https://kukesi.gov.al/projektet-ne-zbatim/</a></p> <p><a href="https://kukesi.gov.al/aplikime-ne-thirrje-te-ndryshme/">https://kukesi.gov.al/aplikime-ne-thirrje-te-ndryshme/</a></p> <p>si dhe në rrjetin social të Njesisë së Integrimit Evropian: <a href="https://www.facebook.com/profile.php?id=100068648989682">https://www.facebook.com/profile.php?id=100068648989682</a></p> <p>Bashkia dhe shoqeria civile i gjen ne linkun me poshte:</p> <p><a href="https://kukesi.gov.al/informacion-tjeter/">https://kukesi.gov.al/informacion-tjeter/</a></p> <p><a href="https://kukesi.gov.al/regjistri-peticioneve-iniciativa-qytetare/">https://kukesi.gov.al/regjistri-peticioneve-iniciativa-qytetare/</a></p> | E plotë | Pa pagesë |

|   |            |  |            |  |         |           |
|---|------------|--|------------|--|---------|-----------|
|   |            | <p>Te dhenat e koordinatorit per njoftimin dhe konsultimin public</p> <p>6. Emer/Mbiemer I koordinatorit<br/>7. Adresa postare/elektronike te tij</p> <p>Plani vjetor per procesin e vendimmarrjes me pjesemarrje</p> <p>8. Aktet qe jane konsultuar/do te konsultohen ne vitin 2022<br/>9. Menyrat e konsultimit<br/>10. Afatet</p> <p>Njoftimi per nismen vendimmarrese me pjesemarrje ne vitin 2022</p> <p>11. Projektakti, relacioni shpjegues dhe dokumentat shoqerues te tij<br/>12. Arsyet e nevojshme per nxjerrjen e projektaktit si dhe ndikimi qe ai do kete<br/>13. Afati, vendi dhe menyra me te cilen palet e interesuara paraqesin ose dergojne rekomandimet e tyre<br/>14. Adresa e kontaktit te koordinatorit per njoftimin dhe konsultimin public te bashkise ose struktures pergjegjese per mbledhjen e rekomandimeve e te komenteve per projektaktin<br/>15. Vendi dhe date e organizimit te takimit public ne rastet kur bashkia vendos per organizimin e tij</p> |            | <p>Nuk kemi koordinator per njoftimin dhe konsultimin public</p> <p>Plani vjetor per procesin e vendimmarrjes me pjesemarrje/ Aktet/ Njoftimet/ Degjesat publike I gjeni ne linkun me poshte:</p> <p><a href="https://kukesi.gov.al/keshilli-bashkiak/">https://kukesi.gov.al/keshilli-bashkiak/</a></p> |         |           |
| 4 | 13.02.2023 | 1. Në çfarë fazë ndodhet projektimi i investimit tek   | 15.02.2023 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.9/1 Prot, Date 14.02.2023  | E plotë | Pa pagesë |

|   |            |   |            |  |         |           |
|---|------------|---|------------|--|---------|-----------|
|   |            | <p>Pallati i Kulturës “Elez Braha”?</p> <p>2. Kur do të fillojnë punimet në këtë godinë?</p> <p>3. Cila është vlera monetare që do të investohet për këtë projekt?</p> <p>4. Çfarë ndryshimesh parashikohet të ndodhin pas investimit në Pallatin e Kulturës së fshatit Bicaj?</p>  |            |  |         |           |
| 5 | 21.03.2023 | <p>- A ka qendra rinore pranë bashkisë suaj?</p> <p>-Në se po, lutemi të na saktësoni numrin e qendrave, emërtimin e tyre, si dhe objektin e veprimtarisë.</p>  | 27.03.2023 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.86/1 Prot, Date 27.03.2023 | E plotë | Pa pagesë |
| 6 | 31.03.2023 | <p>Kërkoj informacion për premtimin për ta kthyer Kukësin nëntokësor në muze duke u nisur nga kjo deklaratë:</p> <p><i>“Ne kemi fituar një projekt nga një shoqatë Italiane afër 2.7 milion euro. Në fazën e parë jemi shpallur fitues. Presim të nënshkruajmë kontratën për vazhdimin e projektit. Pa dyshim që do të vijnë italianët këtu, por do të shkojmë edhe ne në Itali për të biseduar për projektin. Do të punohet nëntokë për ta kthyer këtë qytet që është i rrallë për Shqipërinë për ta kthyer në një qytet muzeal për vizitorë jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj. Besoj se do të jetë diçka e mirë për të ardhurat e bashkisë”,</i> u shpreh Gjici.Doja të kisha informacion se çfarë është bërë me këtë ide?</p> | 13.04.2023 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.1385 Prot, Date 13.04.2023 | E plotë | Pa pagesë |

|   |            |  |            |   |         |           |
|---|------------|--|------------|---|---------|-----------|
| 7 | 03.04.2023 | <p>1. Përse Njësia Administrative Shishtavec në Bashkinë Kukës lëshon dy lloje të vërtetimit për përkatësi të Minoritetit Bullgar? Bazuar në dokumentet e mëparshme të lëshuara dhe administruara nga institucioni (kopjet e të cilave i disponojmë), në këtë NJA janë lëshuar vërtetime që deklarojnë përkatësisht:</p> <p>a) Se shtetasit “janë deklaruar para noterit me Prejardhje Bullgare dhe i Përket Pakicës Bullgare”</p> <p>b) Vërtetim se shtetasit (ku janë specifikuar kredencialet) i përkasin Pakicës Bullgare;</p> <p>2. Këto vërtetime të dylojshme, sipas raportimit dhe dokumentave të vëna në dispozicion nga qytetarët; janë të ndryshme nga vërtetimet që lëshojnë të gjitha Njësitë Administrative ku sipas ligjit 97.2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, ka qytetarë që i përkasin komunitetit Bullgar, përkatësisht njësitë administrative në: zonën e Gorës, Gollobordës dhe Prespës. Në të cilat këto shkresa saktësojnë përkatësinë e qytetarëve komunitetin Bullgar, e jo vetëm vetë deklarin e tyre tek noteri.</p> | 18.04.2023 | <p>Ne Njesine Administrative Shishtavec jane leshuar disa lloj modelesh per vertetime Per Pakicat Bullgare ne Shqiperi dhe me juristet e Bashkise Kukes po punojme me nje model te ri vertetimi per te mos penalizuar qytetaret dhe te jet nje model i rregullt sipas Ligjit</p>  | E plotë | Pa pagesë |
| 8 | 17.04.2023 | <p>Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 15.04.2023, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti XIII i Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK),</p>  | 19.04.2023 | <p>Nisur nga denocimi i bërë nga Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me një veprimtari të publikuar më datë 12 Prill 2023, në faqen zyrtare të kryetarit/kandidatit , ju bëjmë me dije se: Aktiviteti i publikuar në ndërfaqen e</p> | E plotë | Pa pagesë |

|   |            |   |            |   |         |           |
|---|------------|---|------------|---|---------|-----------|
|   |            | <p>për gjetjet dhe rekomandimet për javën 06 Prill 2023 - 13 Prill 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve.</p> <p>Nëpërmjet këtij raporti, është marrë indicie për organizmin e 1 (një) veprimtarie publike nga Institucioni Juaj.</p> <p>Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na informoni mbi arsyen e mosraportimit të veprimtarisë objekt denoncimi, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijani e këtij email-i.</p>  |            | <p>kryetarit/kandidatit, është aktivitet politik i organizuar nga subjekti partiak, në të cilën kandidon kandidati.</p> <p>Kryetari/kandidati në këtë rast ka ndjekur agjenden e tij si kandidat dhe figurë politike. Si e tillë kjo axhendë nuk përfshihet në raportimet e aktivitetit të Bashkisë Kukës, kjo sipas Kodit Zgjedhor si dhe sipas shkresës suaj Nr.2299 Prot, Date 31.03.2023.</p>   |         |           |
| 9 | 08.05.2023 | <p>1. Neni 7, pika 1/b, i Ligjit për Rininë, parashikon për NJVV-të krijimin e Këshillit Vendor të Rinisë. Aktualisht në cilën fazë është procesi i themelimit të këtij këshilli në bashkinë tuaj? (<i>Është ngritur, është në proces administrativ për tu ngritur, apo është në plan për tu ngritur?</i>)</p> <p>2. Nëse Këshilli Vendor Rinor (KVR) është ngritur, ju lutemi informoni mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Përbërjen e tij (anëtarësinë përfshirë dhe organizatat që të rinjtë përfaqësojnë);</li> <li>-Nëse janë realizuar mbledhje dhe sa të tilla që prej ngritjes së KVR-së.</li> </ul> <p>3. Neni 7, pika 1/c parashikon organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendorë në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve. Në këtë kuadër:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Në bashkinë tuaj a ka dokument lokal strategjik për rininë (<i>plan strategjik; strategji; apo çdo dokument tjetër ku bashkia paraqet</i></li> </ul> | 12.05.2023 | <p><b>1.</b>Bashkia Kukësit e ka të ngritur dhe funksional Këshillin Vendor të Rinisë. Këshilli ka funksion këshillimor pranë kryetarit të bashkisë.</p> <p><b>2.</b>Përzgjedhja e të rinjve është bërë duke u bazuar në ligjin 75/2019 “Për Rininë” si dhe udhëzimeve për ngritjen e këshillit.</p> <p>- Me vendim nr.20 datë 26.05.2021 këshilli bashkiak ka miratuar ngritjen e KVR-së. Këshilli Rinor ka në përbërjen e tij 6 (gjashtë) anëtar. Të rinjtë e përzgjedhur janë bërë sipas udhëzimeve ligjore si dhe përmbushjes së kriterëve të vendosura në thirrjen për plotësimin me anëtar të KVR-së. Të rinjtë anëtar të KVR-së prej vitesh janë aktivist dhe vullnetarë të çështjeve dhe politikave rinore në qytetin e Kukësit. Mbledhja e parë është organizuar me 8 dhejtor 2021.</p> <p>- Dëri tani janë zhvilluar katër mbledhje në të cilat anëtarët kanë zgjedhur sekretarin e këshillit, kanë miratuar planin e punës për</p> | E plotë | Pa pagesë |

*objektiva vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve’?*

-Nëse po, a është i publikuar në faqen e Bashkisë? (*Do vlerësonim nëse referoni ku konkretisht*)

-Nëse jo, a ka një plan në bashki që parashikon përmbushjen e ligjit në lidhje me këtë pikë?

4. Neni 7, pika 1/dh, parashikon financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta.

-Në PBA aktuale a ka zë/zëra të dedikuar për këtë çështje në bashkinë tuaj?

-Nëse po ju lutem specifikoni programin buxhetor përkatës në PBA 2023-2025.

5. Neni 7, pika 1/e, parashikon krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë.

-A ka një strukturë administrative për çështjet e rinisë në organikën e aparatit të bashkisë suaj?

-Nëse po, ju lutemi të specifikoni:  
 --njësinë (drejtorinë/ sektorin/ etj.);  
 --të dhënat e pikës së kontaktit/punonjësit rinor që mbulon çështjet e rinisë: Emër mbiemër, email zyrtar.  
 --Si dhe informacion nëse kjo pikë kontakti ka në përshkrim pune vetëm mbulimin e çështjeve rinore apo dhe përgjegjësi/fusha të tjera.

6. Neni 7, pika 1/ë, përmend parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore.

vitin 2022,2023 si dhe kanë evidentuar problematika të ndeyshme rinore.

**3.**Bashkia ka strukturën administrative për çështjet e rinisë, Drejtoria e Projekteve dhe Rinisë. Drejtoria ka 5 (pesë) punonjës.

Bashkia Kukësit e ka një dokument lokal strategjik për rininë që është “Plani Local I Veprimit për Rininë”.

Nuk është publikuar akoma për arsye të miratimit në Këshillin Bashkiak.

Sapo të kryhen hapat përfundimtarë për miratimin e kësaj strategjie lokale të veprimit për rininë, do përmbushet ana ligjore në këtë pikë,duke bërë publikimet në faqen zyrtare të bashkisë.

**4.**Bashkia e Kukësit ka në dispozicion të të rinjve, aktiviteteteve dhe nismave që ata ndërmarrin ambjentet e pallatit të kulturës “Hasan Prishtina”, “American Corner” dhe së shpejti do të kenë edhe qendrën e re multifunksionale “NOK”, e cila është ndërtuar dhe mobiluar.

Në PBA aktuale ka zë të dedikuar për këtë çështje për të kryer aktivitetet sipas kalendarit vjetor të aktiviteteteve në bashkëpunim me Qendren Kulturore të Fëmijëve, Bashkia Kukës.

**5.**Bashkia ka strukturën administrative për çështjet e rinisë, Drejtoria e Projekteve dhe Rinisë. Drejtoria ka 5 (pesë) punonjës.

**6.**Bashkia ka zëra të dedikuar në PBA 2023-



-A ka parashikuar bashkia juaj zë të dedikuar në PBA 2023-2025 për këtë çështje?

-Nëse po, ju lutem specifikoni programin buxhetor.

7. Neni 7, pika 1/f parashikon mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

-A e realizon bashkia juaj këtë detyrim?

-Nëse po ju lutemi të referoni raste specifike.

8. A ka institucioni juaj një databazë të organizatave rinore/për të rinjtë që operojnë në bashkinë tuaj?

-A bashkëpunoni me organizata të shoqërisë civile për çështjet rinore (si përshembull nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre)?

-Si do ta vlerësonit këtë bashkëpunim?

9. Neni 7.pika 4 parashikon se Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me organizatat për të rinjtë e organizatat rinore shqiptare në diasporë, për të mbajtur komunikimin me të rinjtë shqiptarë që janë larguar nga vendi për arsye studimesh ose të tjera, me qëllim angazhimit në aktivitetet që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë.

-Keni raste bashkëpunimi të këtij kuadri?

10. A jeni angazhuar në realizimin e masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022-2029 për Bashkitë? Nëse po, ju lutemi të

2025 për këtë çështje për realizimin e aktiviteteve sipas kalendarit vjetor të aktiviteteve të miratuar në fillim të vitit. Këto aktivitete kryhen në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve, Bashkia Kukës.

7.Sipas pikës “1/f”, neni 7 që parashikon mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre, Drejtoria e Rinisë që funksionon pranë bashkisë Kukës që prej vitit 2015 e realizon këtë detyrim duke kërkuar informacione dhe raportime nga institucione të tjera dhe duke i paraqitur pranë eproreve tanë në bashki në mënyrë periodike.

Raste të tjera bashkëpunimi mund të përmirësojmë rastin e bashkëpunimit me AKPA, me Zyrën Vendore Arsimore, me organizatën Terre Des Homme dhe organizatat e tjera lokale me qëllim mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave për të krijuar planin lokal të veprimit për rininë dhe problematikat rinore etj.

8.Institucioni jonë e ka një databazë të organizatave rinore/ për të rinjtë që operojnë në bashkinë tonë.

- Për sa i përket bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile për çështjet rinore ( si përshembull nxitja e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimi joformal i tyre) përgjigjia është absolutisht po.

- Vlerësimi për këtë bashkëpunim me

|    |            |   |            |  |         |           |
|----|------------|---|------------|--|---------|-----------|
|    |            | paraqisni informacion në çfarë faze është ky proces.  |            | <p>organizata të shoqërisë civile për çeshtjet rinore është maksimal.</p> <p><b>9.</b>Bashkia Kukës, ka të ngritur Njësinë për Diasporën dhe Migracionin, e cila është pjesë e Drejtorisë së, Integritimit Evropian, Diasporës dhe Migracionit dhe themeluar me datë 09.07.2020, me vendim Këshilli Bashkiak nr.131, datë 23.06.2020, Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Kukës, nr.110, datë 07.07.2020 “Për miratimin e një ndryshimi në strukturën e administratës së Bashkisë Kukës”. Kjo drejtori ka ndjekur trajnime për rritjen e kapaciteteve të stafit si dhe është hartuar Plani i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2022-2025. Lidhur me fushat e veprimit të pikave të parashikuara në këtë plan, Njësia për Diasporën dhe Migracionin për vitin 2023 ka në planin e saj vjetor të punës ndër të tjera dhe hartimin e një liste të kontaktit me të rinjtë e organizatat rinore në diasporë që janë larguar për arsye studimesh dhe jo vetëm.</p> <p><b>10.</b>Në kuadër të projektit RAYS kemi marrë pjesë në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-2029, së bashku me Këshillin Vendor Rinor.</p> <p>Ky process tashmë ka mbaruar dhe është bërë publikimi i Strategjisë Kombëtare për Rininë.</p> |         |           |
| 10 | 15.05.2023 | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Si është i organizuar shërbimi veterinar në bashkinë tuaj?</li> <li>2. Sa veteriner janë në strukturën e shërbimit veterinar?</li> <li>3. Sa është fondi i përcaktuar në buxhet për shërbimin veterinar në 5 vitet e fundit (specifikojeni sipas</li> </ol> | 23.05.2023 | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ne Bashkinë Kukës shërben një veterinar</li> <li>2. Prandaj drejtorisë së zhvillimit të bujqësisë.</li> <li>3. Fondi i përcaktuar në buxhet për shërbimin veterinar në 5 vitet e fundit ka qenë si më poshtë: Për çdo vit nga 80.000 Leke të reja.</li> </ol>  | E plotë | Pa pagesë |

secilit vit)?

4. A keni hartuar program pune të profilaksisë veterinarë në lidhje me situatën epizootike të qenve dhe maceve të rrugës, si edhe programe për kontrollin dhe lëvizjen e tyre?  
 - Nëse po, na e vendosni në dispozicion;

5. A i keni identifikuar qentë dhe macet e rrugës në territorin që administroni?  
 - Nëse po, sa është numri i tyre në 5 vitet e fundit?  
 (nëse i keni të ndara sipas muajve, njësive administrative, ju lutem specifikojeni);

6. Si e organizoni sterilizimin e organeve të riprodhimit të qenve dhe të maceve të rrugës?

7. Si i grumbulloni qentë dhe macet e rrugës?

8. A keni vende të posaçme, të miratuara, në të cilat i dërgoni?

9. Në cilat raste realizoni eliminimin e qenve dhe të maceve të rrugës dhe si e realizoni procesin?  
 - Nëse i keni eliminuar ato për arsyet që do i listoni, ju lutemi na informoni për numrin e qenve dhe maceve të eliminuar në 5 vitet e fundit (specifikojini sipas secilit vit);

10. A keni konstatuar raste ku ka pasur braktisje të qenve dhe maceve nga pronarët përkatës dhe çfarë masash keni marrë?

11. Çfarë masash keni marrë që në ambientet publike, si: rrugë, parqe, kënde lojërash etj., kafshët e shoqërimit të mos paraqesin rrezik për njerëzit ose për kafshët e tjera?

12. Çfarë masash keni marrë për të

4. Eshte hartuar plan programi i punes mbi profilaksine veterinarë ne lidhje me situatën epizootike te qeneve dhe te maceve te rruges si dhe program per kontrollin dhe levizjen e tyre.

5. Jane vaksinuar qenet dhe macet e rruges sipas kalendarit te vaksinimit per here te pare dhe ne mosha te rritura.

6. Tek -macet lloji i vaksines: Panleukopenia, Calciviroze, Rinotrakeit te cilat jane çertifikuar edhe per udhetime jashte vendit (Vaksine 1 vjeçare)

7. Nuk kemi identifikuar qente te rruges pa pronar ne territorin e bashkise tone.

8. Nuk kemi organizuar sterilizimin e. qeneve dhe te maceve te rruges.

9. Nuk ka strihomore te qeneve.

10. Nuk kemi eliminuar per asnje arsye qene ose mace.

11. Nuk kemi marre masa ne ambientet publike si rruge, parqe, ose kende lojrash pasi nuk ka pasur kafshe pa pronar.

12. Nuk kemi konstatuar asnje rast te helmimit te qeneve dhe te maceve.

13. Nuk ka pasur qene te braktisur nga pronaret.

14. Nuk ka pasur sjellje te qenve nga territoret te tjera te vendit.

15. Nuk kemi marre asnkesa ne menyren e

vendosur dhe për të zbatuar në territorin që administroni, detyrimin për pronarët që të vendosin maskën mbrojtëse në gojë për qentë e shoqërimin të racave agresive gjatë qëndrimit të tyre në ambientet publike?

13. A keni konstatuar raste të helmimit të qenve dhe të maceve të rrugës?  
- Nëse po, si keni vepruar në këto raste?

14. A keni referuar tek autoritetet ligjzbatuese raste të braktisjes, helmimit apo të vrasjes së qenve apo të maceve të rrugës?  
- Nëse po, na informoni për secilin rast;

15. A keni informacion për sjelljen e maceve dhe kafshëve të rrugës nga territore të tjera të vendit në territorin e bashkisë suaj?

16. A keni marrë ankesa për mënyrën se si e menaxhoni situatën e maceve dhe të qenve të rrugës?  
- Nëse po, na informoni për numrin e tyre në 5 vitet e fundit;

17. A keni ngritur qendra vaksinimi, kastrimi dhe sterilizimi për macet dhe qentë e rrugës?  
Nëse po, na informoni për adresat e tyre dhe numrin e kafshëve të trajtuara, matrikulluara në 5 vitet e fundit, ndarë sipas kategorive, qen, mace, mosha, tipologjia, etj.;

18. A keni qendra të ngritura për macet dhe qentë e rrugës?  
- Nëse po, si funksionojnë ato, a janë të përkohshme, të përhershme etj.?  
- Si munden qytetarët t'i vizitojnë

manxhimit të kafshëve (maceve dhe qeneve) në territorin e Bashkisë tone.

16. Jane ngritur qendra të vaksinimit të përkohshëm në territorin e Bashkisë Kukes.

17. Nuk kemi qendra të përhershme të maceve dhe qeneve të rrugës.

18. Qytetarët mund të vizitojnë qendrat e përkohshme të ngritura në disa pika të territorit të Bashkisë Kukes.

19. Nuk funksionon qendra e adoptimit të qeneve pasi nuk kemi pasë të tilla të regjistruar Brenda këtij territori.

|    |            |   |   |  |   |  |
|----|------------|---|---|--|---|--|
|    |            | <p>qendrat tuaja dhe si e siguron transparencën për punën tuaj?</p> <p>19. A keni strehëza të përhershme të ngritura për macet dhe qentë e rrugës që janë në pritje të adoptimit?</p> <p>- Nëse po, si funksionojnë ato?</p> <p>20. Si funksionon adpotimi i qenve dhe i maceve të rrugës që ju i grumbulloni në territorin tuaj, nëse e ofroni këtë shërbim?</p>   |   |  |   |  |
| 11 | 19.05.2023 | <p>- Informacion i disponueshem mbi investimet ne bashkine e Kukesit, njesia administrative Kalis dhe Bushtrice, per periudhen 2013-2023 ose periudhen qe ju e keni si informacion.</p> <p>- Informacion mbi masen e subvencionimit te bujqesise ne bashkine e Kukesit,,njesia administrative Kalis dhe Bushtrice, nese eshte e mundur, sic eshte gjendja faktike ne vitin 2023..</p> <p>- Informacion mbi token bujqesore te punueshme ne kete zone (njesite administrative njesia administrative Kalis dhe Bushtrice) dhe periudhen, si me siper sic eshte gjendja faktike ne vitin 2023..</p> <p>- Informacion mbi siperfaqen e mbjelle me dru frutore ne kete zone dhe periudhen, si me siper sic eshte gjendja faktike ne vitin 2023..</p> <p>- Informacion mbi numrin e objekteve te kultit ne kete zone dhe periudhen, si me siper sic eshte gjendja faktike ne vitin 2023..</p> | Ne pritje per saktesimin e identitetit. |  | Ne pritje per saktesimin e identitetit. |  |

|    |            |   |            |  |         |           |
|----|------------|---|------------|--|---------|-----------|
|    |            | <p>- Informacion mbi numrin e familjeve apo personave qe trajtohen me asistence sociale dhe ndihme ekonomike, ne kete zone dhe periudhen, si me siper sic eshte gjendja faktike ne vitin 2023..</p> <p>- Informacion mbi gjendjen e punesimit si dhe te papunesise, ne kete zone dhe periudhen si me siper sic eshte gjendja faktike ne vitin 2023..</p> <p>- Informacion mbi numrin e banoreve si dhe banesave ne kete zone, si me siper, sic eshte gjendja faktike ne vitin 2023.</p> <p>-Informacion mbi operatoret ekonomike ne kete zone, si me siper dhe periudhen, vecanerisht, ne fushen e prodhimit te energjise nga era, dielli, gazi, akrosolare dhe teknologji te tjera, sic eshte gjendja faktike ne vitin 2023.</p> |            |  |         |           |
| 12 | 01.06.2023 | Cilat janë investimet e realizuara në segmentin e vjetër të rrugës Milot-Kukës gjatë periudhës janar 2019-janar 2023? Sa kanë kushtuar këto investime?  | 09.06.2023 | Ky segment rrugor eshte ne inventarin e rrugeve nacionale, mirembahet nga kompani koncesionare dhe per rrjedhoje informacionin per kete rruge duhet ta kerkoni prane A.Rr.Sh-se, ose ti drejtoheni kompanise konçensionare     | E plotë | Pa pagesë |
| 13 | 15.06.2023 | <ul style="list-style-type: none"> <li>Investimet apo projektet e Bashkise për Turizmin ne Kukës</li> <li>Numrin e turisteve qe vizitojnë Kukësin (Data baza / 2017-2022,2023)</li> <li>Të ardhurat nga turistët (Data baza / 2017-2022,2023)</li> </ul>  | 26.06.2023 | <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Investimet dhe projekte në zbatim nga Bashkia Kukës</b></li> <li>A. Bashkia Kukës si partner: (Financuar nga BE)</li> <li><b>1. Projekti i nëntokës: “EMOunderground”</b></li> </ul> | E plotë | Pa pagesë |

- Akomodimet e turistëve në Kukës
- Programin promovues për turizmin në Kukësit (2022-2023)

**Programi:** INTERREG V-B Adriatic-Ionian ADRION Programme 2014-2020

**2. "Ujë i pastër në Kukës dhe Gjakovë"**

**Programi:** IPA CBC Programme Albania-Kosovo

B. Bashkia Kukës si lider (Financuar nga BE)

**3. Mundësi të reja Kukës – NOK**

**Programi:** EU for socio-economic development (as alternative to drugs cultivation and trafficking)

**4. ECO-ROUTES**

**Programi:** IPA CBC Albania-Kosovo (Programi ndërkufitar Shqipëri Kosovë)

**5. Programi ReLOaD - Financuar nga BE, zbatuar nga UNDP**

Skema e granteve: Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2),

C. Projekte nga donatorë të tjerë:

**1.** Ngritja dhe funksionimi i strehësës së emergjencës për gratë dhe vajzat e dhunuara – Thirrje nga **Ministria e Shëndetësisë**.

**2. Projekti** "Integration of children in the process of education and development in a pleasant environment"

**Donator:** Ambasada Bullgare

**3. Projekti "Parku i Aventurave në Shishtavec"**

**Programi:** Skemës së Granteve të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit të Programit (PZHRSH).

**4. Jo vetëm sport por dhe argëtim**

|    |            |  |            |  |           |
|----|------------|--|------------|--|-----------|
|    |            |  |            | <p><b>Programi:</b> Save the Children</p> <p><b>5. Binjakezimi me Bashkine e Lubekut ne Gjermani.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numri i turisteve per vitin qe kane vizituar Kuketin per vitin 2022 eshte 37000 turist ndersa per vitin 2023 deri tani kuketin e kane vizituar rreth 10000 turist.</li> <li>• Programet promovuese për Turizmin në Kukës për vitin 2022-2023 janë festimi i festave lokale. (bashkangjitur tabela)</li> </ul> |           |
| 14 | 22.06.2023 | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sa është numri i shkollave në bashkinë tuaj?</li> <li>2. Sa ka qenë numri i nxënësve në 9-vjecare në vitin shkollor 2021-2022 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për klasën e parë?</li> <li>3. Sa ka qenë numri i nxënësve në 9-vjecare në vitin shkollor 2022-2023 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për klasën e parë?</li> <li>4. Sa ka qenë numri i nxënësve në gjimnaz në vitin shkollor 2021-2022 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për vitin e parë?</li> <li>5. Sa ka qenë numri i nxënësve në gjimnaz në vitin shkollor 2022-2023 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për vitin e parë?</li> <li>6. Sa shkolla janë mbyllur përgjatë</li> </ol> | 30.06.2023 | <p>Informacioni i kerkuar nga ju nuk eshte competence e Bashkise Kuket.</p> <p>Kete informacion mund ta gjeni ne Zyren Arsimore Kuket.</p>   | Pa pagesë |



|    |            |   |            |   |         |           |
|----|------------|---|------------|---|---------|-----------|
|    |            | viteve 2021-2023?   |            |   |         |           |
| 15 | 27.06.2023 | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bazuar mbi cilin dokument (dorëheqje apo shkarkim) vendosi këshilli bashkiak zëvendësimin e ish kryetarit ? Lutemi te na vini ne dispozicion dokumentin ne fjale.</li> <li>2. Lutemi te na dërgoni vendimin e këshillit bashkiak per emërimin e z.____ si drejtues te Bashkise Kukes.</li> <li>3. Cila ishte data e mbledhjes se pare te konstituimit te këshillit bashkiak te dale nga zgjedhjet e 2023-shit?</li> <li>4. A u be betimi pas zgjedhjeve te 14 Majit 2023?</li> </ol>  | 05.07.2023 | Kthyer pergjigje me E-mail. Dhene dokumenti i kerkuar.  | E plotë | Pa pagesë |
| 16 | 30.06.2023 | Kerkese per informacion mbi nderhyrjet, projektet, nismat ne Bashkine Kukes   | 12.07.2023 | Kthyer pergjigje me E-mail.   |         | Pa pagesë |
| 17 | 04.07.2023 | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sa është numri i punësimeve të reja nisur nga 31 Maji 2022 e deri më 31 Maj 2023 (të ndarë sipas kontratave të punësimit, i përhershëm dhe i përkohshëm)?</li> <li>• Në cilat pozicione janë emëruar të punësuarit gjatë periudhës kohore 31 Maj 2022-31 Maj 2023?</li> <li>• Sa është numri i punonjësve, pjesë e Bashkisë dhe institucioneve në varësi në fund të muajit Maj 2023.</li> <li>• Kërkojmë që të na vihet në dispozicion vendimi i emërimeve në detyrë për të gjithë të punësuarit me kohë të plotë apo të pjesshme, direkt në organigramën e bashkisë apo institucioneve në varësi gjatë periudhës kohore 31 Maj 2022-31 Maj 2023.</li> </ul> | 17.07.2023 | <p>Nr i te punesuarve per periudhen 31.05.2022-31.05.2023 eshte:</p> <p>Total 112</p> <p>Akte punesimi:</p> <p>Administrate 34</p> <p>Punonjes 66</p> <p>Police 3</p> <p>MZSH 9</p> <p>Nga keto 33 jane me kontrate te perkohshme</p> | E plotë | Pa pagesë |

|    |            |  |            |   |         |           |
|----|------------|--|------------|---|---------|-----------|
| 18 | 11.07.2023 | <p>1. A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor te planifikuar per rinine (grup moshen 15-29 vjec) per periudhen janar -dhjetor 2022? Nese po, sa perqind te shurnes totale te buxhetit zene keto zera? Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka nje planifikim te tille?</p> <p>2. A ka te punesuar prane Bashkise suaj individe te moshes 18-29 vjec (perfshire drejtuesit)? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?</p> <p>3. Sa eshte perqindja e te rinjve (18-29 vjec) te punesuar krahasuar me numrin total te administrates?</p> <p>4. A ka Bashkia juaj politika rinore te zhvillura specifikesht per grup moshen 15-29 vjec? Nese po a mund te na dergoni nje kopje te tyre? Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka te zhvilluar nje politike te tille?</p> <p>5. A keni ne institucionin tuaj struktura pergjegjese per politikat rinore? Nese po, cilat jane ato (psh. drejtori, sektore, specialiste, struktura perfaqesimi rinor politike etj) dhe prej sa kohesh jane funksionale?</p> <p>6. A ka struktura rinore te ngritura ne Bashkine tuaj dedikuar grupmoshes</p> | 20.07.2023 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.2/1Prot, Me Email | E plotë | Pa pagesë |
|----|------------|--|------------|---|---------|-----------|

|    |            |   |            |  |         |           |
|----|------------|---|------------|--|---------|-----------|
|    |            | <p>se te rinjve 15-29 vjec (qendra/zyra rinore, keshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) per periudhen janar - dhjetor 2022.</p> <p>Nese po, cilat jane ato?</p> <p>7. Me ke keni bashkepunuar per ngritjen e strukturave te tilla (organizata rinore, grupe te rinjsh, individe, etj)</p> <p>8. A keni pasur ju forma te tjera bashkepunimit (me grupe te rinjsh, organizata rinore, etj) per zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinine? Nese po ku kane konsistuar ato?</p> <p>9. Sa eshte me perafersi pjesemarrja e te rinjve ne konsultimet publike te zhvilluara nga bashkia? Cilat jane disa nga mjetet apo mekanizmat qe perdor bashkia ne perfshirjen e te rinjve ne te tilla procese?</p> <p>Te tjera</p> |            |  |         |           |
| 19 | 31.07.2023 | <p>- Sa është fondi në dispozicion për vitin 2023 për emergjencat civile në Bashkinë Kukës?</p> <p>- Sa ka qenë ky fond në vitin 2020, 2021 dhe 2022?</p> <p>- Cili është kapaciteti i bashkisë për emergjencat civile (punonjës, pajisje teknike, logjistike etj)? <u>(Të jenë sa më të detajuara të mundshme)</u></p> <p>- A ka bashkia kapacitete të</p>   | 10.08.2023 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.35/1Prot, Me Email | E plotë | Pa pagesë |

|    |            |   |            |  |         |           |
|----|------------|---|------------|--|---------|-----------|
|    |            | <p>mjaftueshme për të përballuar fatkeqësitë natyrore të tilla si zjarre, përmbytje, tërmetet etj.?</p> <p>- Sa është mbështjetja financiare e marrë nga pushteti qendror për këtë vit për emergjencat civile?</p>  |            |  |         |           |
| 20 | 07.08.2023 | <p>- Sa është numri total i familjeve/individëve që trajtohen me ndihmë ekonomike?</p> <p>- Sa është numri total i familjeve që përfitojnë nga ndihma bllok 6%?</p>   | 09.08.2023 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.36/1Prot, Me Email | E plotë | Pa pagesë |
| 21 | 07.08.2023 | Na identifikoni (numrin dhe emrat) Qendrat Rinore që administrohen nga bashkia Juaj si dhe të qendrave rinore që <u>nuk</u> administrohen prej Jush.  | 08.08.2023 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.37/1Prot, Me Email | E plotë | Pa pagesë |
| 22 | 04.09.2023 | Ju lutemi na dërgoni emrat e ishkrjetarëve të bashkisë suaj nga 1992 dhe në vazhdim si edhe të kryetarit aktual. Ishkrjetarëve të komunave nga 1992 deri në 2015 si edhe listat e personave që janë të komanduar në njesitë administrative të bashkisë suaj .   | 14.09.2023 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.53 Prot, Me Email  | E plotë | Pa pagesë |
| 23 | 04.09.2023 | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sa është numri i shkollave në Bashkinë tuaj?</li> <li>2. Sa ka qenë numri i nxënësve në 9-vjeçare në vitin shkollor 2021-2022 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për klasën e parë?</li> <li>3. Sa ka qenë numri i nxënësve në 9-vjeçare në vitin shkollor 2022-2023 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për klasën e parë?</li> <li>4. Sa ka qenë numri i nxënësve në gjimnaz në vitin shkollor 2021-2022 në bashkinë tuaj? Po të regjistruar për vitin e parë?</li> <li>5. Sa ka qenë numri i nxënësve në gjimnaz në vitin shkollor 2022-</li> </ol> | 06.09.2023 | Deleguar Zyres Vendore Arsimore Kukes              |         |           |

|    |            |   |            |   |         |           |
|----|------------|---|------------|---|---------|-----------|
|    |            | <p>2023 në bashkinë tuaj? Po të</p> <p>9. regjistruar për vitin e parë?</p> <p>10. Sa është numri aktual i shkollave në Bashkinë tuaj?</p> <p>11. Sa ka qenë numri i shkollave në vitin 2018?</p> <p>12. Sa shkolla janë mbyllur gjatë periudhës janar 2018-janar 2023?</p> <p>13. Sa ka qenë numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare gjatë vitit shkollor: 2017-2018/ 2018-2019/ 2019-2020/ 2020-2021/ 2021-2022/ 2022-2023?</p> <p>14. Sa ka qenë numri i nxënësve në shkollat 9-vjeçare gjatë vitit shkollor: 2017-2018/ 2018-2019/ 2019-2020/ 2020-2021/ 2021-2022/ 2022-2023?</p> |            |   |         |           |
| 24 | 16.10.2023 | <p>Bashkepunimet e realizuara nga Bashkia juaj me njesi vendore jashte Shqiperise. (kumuna,provinca,rajone etj.)</p>  | 22.10.2023 | <p>1. Bashkepunimi me Bashkine Lubeck te Gjermanise ne kuader te ngritjes se kapaciteteve si dhe paisjes me kosha per grumbullimin e mbetjeve dhe makinerive per transportimin e tyre. Ky project eshte ne vazhdim.</p> <p>2. Ne bashkepunim me komunen e Nardo-s ne Itali kemi projektin EMUnderground. Eshte projekt i zbatuar ne kuader te programit ADRION dhe i financuar nga Bashkimi Evropian. Bashkia Kukës është partner në këtë projekt, i cili ka për qëllim të jap një kontribut në vlerësimin e pasurive dhe potencialeve të aseteve kulturore të cilat do të çojnë në një zhvillim të qëndrueshëm, të zgjuar dhe gjithëpërfshirës në të gjithë zonën ku shtrihet projekti. Ky project eshte mbyllur.</p> <p>3. Bashkepunimi me komunen Alytus ne Lituani ne kuader te programit Town Twinning. Ky project synon promovimin e dialogut nderkulturor nepermjet vendeve te</p> | E plotë | Pa pagesë |

ndryshme duke u dhene mundesine qytetareve per te marre pjese e angazhuar ne aktivite te perbashketa. Projektet japin mundesi qe te targetohen tematika te ndryshme fokusuar ne prioritetet e BE-se. Objektivi i kesaj thirrjeje eshte promovimi i shkembimeve ndermjet qytetareve te vendeve te ndryshme, veçanerisht nepermjet binjakezimit te qyteteve, per tu dhene atyre pervojen ne praktike te pasurise dhe diversitetit te trashegimise se perbashket te Bashkimit Evropian dhe te ndergjegjesoje se keto perbejne themelin per nje te ardhme te perbashket. Jemi ne pritje te nje perjigjije per shpalljen fitues ose jo te ketij projekti

4. Ne kuader te programit IPA Cross Border Cooperation kemi projekte te perbashketa me disa komuna te Kosoves sic jane:

- Projekti ECO ROUTES me focus ne zhvillimin e turizmit, promovimin e trashegimise kulturore dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Bashkia kukes eshte ne rolin e liderit te projektit dhe partner jane Urban Research Institute, Komuna e Rahovecit dhe Green Art Center –Prishtinë. Projekt I cili vahdon te implementohet.
- Projekti Uji I Paster Kukes-Gjakove, ka si qellim rehabilitimin e Kolektorit të ujërave të zeza (KUZ) në qytetin e Kukësit, Ky projekt është zbatuar nga She-ERA, në partneritet me ACER, Komuna e Gjakovës dhe Bashkia e Kukësit. Ky project ka mbaruar me sukses.
- Pastrimi I liqenit te Fierzes, Projekt ne bashkepunim me komunen e Prizrenit. Implementimi I projektit eshte ne vazhdimesi.

|    |            |   |            |  |         |           |
|----|------------|---|------------|--|---------|-----------|
| 25 | 21.11.2023 | <p>a) Ku do mësojnë nxënësit gjatë periudhës së restaurimit të gjimnazit “Bajram Avdiu” në Bicaj të Kukësit?</p> <p>b) Kur do të fillojë procesi i restaurimit të gjimnazit dhe kur pritet të përfundojë?</p> <p>c) A garantohej cilësia e punimeve në kushtet e temperaturave të ulëta që do të jenë gjatë dimrit?</p> | 22.12.2023 | <p>a.Gjatë periudhës së restaurimit të gjimnazit “Bajram Avdiu, Bicaj” nxënësit e shkollës do të zhvillojnë procesin mësimor gjatë orarit të pasdites në shkollën 9-vjeçare “Avdi Shehu” në Bicaj.</p> <p>b.Përsa i përket procesit të restaurimit ai ka filluar me datë 03.11.2023 me afat realizimi 8 muaj nga nënshkrimi i kontratës duke marrë parasysh edhe periudhën nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit.</p> <p>c.Po garantohej</p>   | E plotë | Pa pagesë |
| 26 | 19.12.2023 | <p>Per fshatin Borje Pse nuk është rregulluar infrastruktura për këta banorë?</p> <p>Cili është spitali më i afërt për ta?</p> <p>A kanë shkolla dhe sa?</p>  | 27.12.2023 | <p>Fshati Borje është një ndër fshatrat me të mëdhenj të Njësise Administrative Shishtavec dhe zonës së Gores ku banojnë rreth 840 banorë</p> <p>Banorët e fshatit Borje janë të lidhur me pjesën e Kosovës për shumë shërbime pasi rruga që lidh fshatin Borje me pjesën e Dragashit është e asfaltuar , kurse pjesa tjetër që lidh fshatin Borje me qytetin e Kukësit nuk është e asfaltuar .</p> <p>Fshati Borje ka një gjendje Shëndetësore dhe një infermiere që punon aty dhe spitali më i afërt është ai i Kukësit .</p> <p>Fshati borje ka një shkollë 9-vjeçare - ku mesojnë 109 nxënës</p> | E plotë | Pa pagesë |

|    |            |  |            |   |         |           |
|----|------------|--|------------|---|---------|-----------|
| 27 | 27.12.2023 | <p>Per fshatin Borje<br/>Sa banorë saktësisht janë në këtë fshat dhe sa kanë migruar ndër vite?</p> <p>Pse nuk është shtruar rruga Borje-Kukës?</p> <p>Ata ankohen edhe për mungesë të ujit, pse po ndodh kjo?</p>   | 28.12.2023 | <p>Ne kete fshat jetojne 840 banor dhe pjesa tjeter jane migrant dhe emigrant ku ne total jane 1153 banor te regjistruar,</p> <p>Rruga nuk eshte shtruar per shkak te mungeses se fondeve ku pjesa me e madhe e fshatrave te kukesit jane rruge rurale.</p> <p>Per sa I perket ujit te pijshem banoret e fshatit borje fumizohen me uje te pijshem nga ujesjellsi qe ndodhet siper fshatit , por problem qendron te Ujesjellsi I Kallabakut I cili eshte ndertuar per te fumizuar tre fshatra : Shishtavec , Novosej dhe Borje , ku nga ky Ujesjelles fshati BorJe nuk fumizohet me uje per shkak se tubat kryesore jane-jasht funksionit</p> | E plotë | Pa pagesë |
| 28 | 28.12.2023 | <p>1.Sa punonjës janë në pozicionin e koordinatorit vendor, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në juridiksionin e bashkisë tuaj?</p> <p>2.Në sa raste (përgjatë viteve 2018, 2019, 2020 , 2021, 2022, 2023) koordinatori ka bashkëpunuar me policinë e shtetit (në sa raste titullari i policisë së shtetit ka njoftuar menjëherë koordinatorin për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare)?</p> <p>3. Sa qendra sociale të rehabilitimit janë ngritur pranë juridiksionit të bashkisë tuaj, për viktimat e dhunës në familje?</p> | 09.01.2024 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.89/1 Prot, Me Email   | E plotë | Pa pagesë |



|    |            |  |            |   |         |           |
|----|------------|--|------------|---|---------|-----------|
|    |            | <p>4. Sa struktura të qendrave publike janë për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve pranë juridiksionit të bashkisë tuaj?</p> <p>5. A keni bashkëpunuar me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes?</p>  |            |   |         |           |
| 29 | 28.12.2023 | <p>Sa është shuma e paguar për konsumin e energjisë elektrike për institucionin tuaj për periudhën 01.10.2021 – 20.10.2023? (të ndara sipas muajve)</p>  | 09.01.2024 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.91/1 Prot, Me Email | E plotë | Pa pagesë |
| 30 | 29.12.2023 | <p>1. Sa zjarrëfikës ka aktualisht struktura e zjarrëfikeseve të Bashkisë Kukës?</p> <p>2. Sa mjete zjarrëfikëse ka në dispozicion Bashkia Kukës? Ju lutem na vendosni në dispozicion të dhënat teknike të këtyre mjeteve zjarrëfikëse, duke nisur që nga viti i prodhimit, kapaciteti, dokumentacioni përkates etj.</p> <p>3. Ju lutem na vendosni në dispozicion një inventar të mjeteve që struktura e zjarrëfikësve zotërojnë për luftën kundër zjarrit.</p> <p>4. A ka zhvilluar tendera Bashkia Kukës për përmirësimin e infrastrukturës kundër zjarreve gjatë 5 viteve të fundit? Nëse po, ju lutem na vendosni në dispozicion dokumentacionet e këtyre tenderave.</p> <p>5. A ka zhvilluar Bashkia e Kukësit tendera gjatë 5 viteve të fundit për pajisje të ndryshme për repartet zjarrëfikëse të cilat janë nën juridiksionin e saj?</p> <p>6. A ka patur donacione drejt reparteve zjarrëfikëse në Bashkinë Kukës? Nëse po, ju lutem na i</p> | 09.01.2024 | Kthyer pergjigje me shkresen Nr.104 Prot, Me Email  | E plotë | Pa pagesë |

|  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|
|  | <p>vendosni në dispozicion, qofshin këto donacione monetare (shumën) apo donacione me mjete dhe pajisje.</p> <p>7. A kanë zjarrëfikësit e terrenit veshjet e specializuara zjarrëduruese dhe maskat mbrojtëse për t'u futur në një zonë që ka marrë flakë? Kur është bërë rinovimi i fundit i këtyre mjeteve?</p> <p>8. A janë të mjaftueshme këto mjete dhe burime njerëzore për t'iu përgjigjur situatave emergjente në Bashkinë e Kukësit?</p> <p>9. A ka bërë ndonjëherë Bashkia Kukës kërkesë për support në strukturat qeveritare për stacionet e saj zjarrëfikëse?</p> <p>10. Sa mjete ajrore të specializuara ka në dispozicion Bashkia Kukës për shuarjen e zjarreve?</p> <p>11. Sa automjete mbështetëse për transportimin e stafit ka Bashkia Kukës në dispozicion?</p> |  |  |  |
|--|--|--|--|--|